

 <p>Policia e Shtetit Akademia e Sigurisë</p>	<p>Përshkrimi i punës i pozicionit: Rektori i Akademisë së Sigurisë.</p>	
<p>Autoriteti miratues: Senati Akademik</p>	<p>Data e miratimit: Vendimi nr.77/1, datë.02.05.2023</p>	<p>Rishikimi fundit: Nr. __. datë. __. __. 2023</p>
<p>Lloji i rregullimit: Përshkrimi i pozicionit të punës</p>	<p>Shpërndarë: Gjithë personelit të Akademisë së Sigurisë</p>	<p>Fusha: Arsimi Policor</p>

I. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS (FUNKSIONIN).

Institucioni: Policia e Shtetit – Akademia e Sigurisë.
 Sektori: Akademia e Sigurisë
 Pozicioni i punës: Rektori i Akademisë së Sigurisë.
 Raporton tek: Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

I. MISIONI

Misioni kryesor i AS është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e arsimit dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese.

AS, si institucion përgjegjës i vetëm i arsimit të lartë publik policor në vend, në të tre ciklet e studimeve universitare, ka për mision formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit e për personat fizike e juridike në fushën e rendit e të sigurisë publike.

AS, në vartësi dhe funksion të Policisë së Shtetit, është një institucion publik i arsimit të lartë dhe zbaton përveç ligjit të Policisë së Shtetit edhe ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore që rrjedhin në zbatim të tyre.

II. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Rektori është autoriteti më i lartë akademik dhe autoriteti drejtues i Akademisë së Sigurisë, si dhe përfaqësuesi ligjor i saj për çështje akademike dhe protokollare, ka përgjegjësinë e përgjithshme për organizimin, menaxhimin e ndjekjen e detyrimeve, problemeve dhe angazhimeve të Akademisë së Sigurisë, si dhe kryen veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për Arsimin e Lartë, në Republikën e Shqipërisë.

III. DETYRAT KRYESORE

Detyrat kryesore të Rektorit të Akademisë së Sigurisë, janë :

a. Drejton Senatin Akademik të AS-së dhe raporton para tij.

- b. Paraqet në Senatin Akademik planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe ndjek zbatimin e tij.
- c. Miraton strukturën e vitit akademik në shkallë institucioni, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- d. Nënshkruan, në emër të AS-së, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, marrëveshjet e bashkëpunimi me strukturat përfituese që përcaktohen në nenin 4 të VKM-së nr. 881, datë 28.10.2020, e ndryshuar, dokumentacionin për anëtarësimin e AS-së në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, marrëveshje bashkëpunimi me subjekte vendase dhe të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e veprimtarisë së institucionit. Këto marrëveshje, protokolle e bashkëpunime, i paraqiten Senatit Akademik për ratifikim. Në rast se çështjet kanë efekte financiare, merret edhe pëlqimi i Bordit të Administrimit. Për marrëveshje me subjekte të huaja, merret paraprakisht pëlqimi i ministrit përgjegjës për Rendin dhe sigurinë publike.
- e. Përfaqëson AS-në, në marrëdhënie akademike dhe protokollare me të tretët.
- f. Mbikëqyr procedurat e përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të personelit, në përputhje me bazën ligjore.
- g. Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmësakademik të AS-së, si dhe vendos për zgjidhjen e tyre në rastet e parashikuara në rregulloren e AS-së;
- h. Urdhëron pezullimin, ndërprerjen apo përjashtimin e studentëve dhe kursantëve nga studimet në rastet e parashikuara në rregulloren e AS-së.
- i. Nënshkruan certifikata, diplomat e ciklit të parë, të dytë pa të drejtë delegimi të nënshkrimit të tyre.
- j. Ngre komisione e grupe pune për çështje, veprimtari të ndryshme, për organizimin, menaxhimin e ndjekjen e detyrimeve, të A.S , me urdhër të vecantë.
- k. Paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t'u shqyrtuar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, dhe Këshilli i Etikës.
- l. Ushtron kontrolle, kryesisht apo me kërkesë të organeve drejtuese të AS-së, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zbatimit të kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër që kryejnë njësitë.
- m. Trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të njërive kryesore dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- n. Shtrohet për diskutim në rektorat ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të njërive kryesore.
- o. Kërkon informacion nga Bordi i Administrimit për çështje të kompetencës së tij.
- p. Kur e çmon të arsyeshme, merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit ku mund të paraqesë sugjerime, opinione, rekomandime, me qëllim përmirësimin e punës, orientimin më të mirë në administrimin e institucionit dhe në përputhje me interesin më të lartë të AS-së.
- q. Kur i kërkohet, merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e organeve dhe të njërive përbërëse të AS-së, në të cilat nuk bën pjesë ligjërisht ose sipas këtij statuti.
- r. Mbikëqyr zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik.
- s. Përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorit dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në *Rregulloren e AS-së*;
- t. Drejton veprimtarinë për hartimin e plan kalendarit të procesit mësimor në shkallë Akademie.
- u. Drejton punën dhe harmonizimin e elementëve përbërës të programit mësimor, duke dhënë direktivat e nevojshme mbi bazën e analizave dhe planifikimit.
- v. Organizon punën me personelin pedagogjik dhe mbështetës të institucionit për të njohur e zbatuar aktet ligjore, nënligjore e normative, kërkesat e rregulloreve, urdhrat e Ministrave të Brendshëm dhe të Arsimit, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.
- w. Deleton funksionet e tij tek zëvendësrektorin në rast të pamundësisë, mungesës ose pushimeve.

- x. Ushtron detyra të tjera, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, të cilat përcaktohen në “Rregulloren e AS-së”.
- y. Rektori, në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet, sipas rastit, me vendime, urdhra dhe udhëzime.

V. PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe objektivat

- a. Planifikon veprimtarinë vjetore të Akademisë së Sigurisë, në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë së Shtetit, si dhe në përputhje me Ligjin Për Arsimin e Lartë.
- b. Planifikon dhe zhvillon një politikë të gjërë bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Akademisë së Sigurisë, me institucione dhe agjensi të tjera të sigurisë, brenda dhe jashtë vendit.
- c. Planifikon, harton dhe propozon projekt-buxhetin vjetor të Akademisë së Sigurisë.
- d. Miraton Programet e Punës për aktivitetin kërkimor shkencor, për vitin akademik, si dhe Programet e Punës për Vitin Akademik, të Strukturave kryesore dhe të Akademisë së Sigurisë
- e. Ndjek realizimin e planeve, programeve dhe objektivave të strukturave kryesore dhe të vetë Akademisë së Sigurisë;

B. Menaxhimin

- a. Është përgjegjës kryesor për organizimin, menaxhimin e ndjekjen e detyrimeve, problemeve dhe angazhimeve të Akademisë së Sigurisë.
- b. Ndjek dhe menaxhon nëpërmjet strukturave në varësi gjendjen moralo – psikologjike të efektivitetit, studentëve/kursantëve dhe personelit, sipas funksioneve organike të Akademisë së Sigurisë.
- c. Menaxhon burimet njerëzore sipas strukturës organike në Akademinë e Sigurisë.
- d. Ndjek, kontrollon dhe menaxhin punën kërkimore shkencore, nëpërmjet Qendrës Kërkimore Shkencore dhe Projekteve në Akademinë e Sigurisë

C. Detyra teknike

- a. Miraton transferimin e krediteve të programeve të studimeve nga një program në një tjetër, sipas ss-tandarteve të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe kritereve përkatëse të përcaktuara në Udhëzimet e MAS-it.
- b. Miraton zgjedhjet e brendshme dhe propozon emërimin e personelit të varësisë së drejtëpërdrejtë, si dhe miraton propozimet e drejtuseve të strukturave kryesore, në A.S.
- c. Organizon konsulta të herë pasherëshme me personelin pedagogjik – shkencor, për probleme të mësimdhënies dhe për probleme të tjera të ndryshme të rëndësishme për A.S.
- d. Organizon punën me personelin pedagogjik dhe mbështetës të institucionit, për të njohur e zbatuar me përpikmëri aktet ligjore dhe nenligjore, kërkesat e akteve normative, si dhe urdhrat dhe Udhëzimet e e DPPSH, Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

D. PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL DHE BASHKËPUNIMI

- a. Asiston Drejtorin e Përgjithëm të Policisë së Shtetit, në çështje që lidhen me arsimimin dhe trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit.
- b. Përfaqëson AS-në, me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në marrëdhënie akademike dhe protokollare me të tretë.
- c. Inicion projekte bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit.

- d. Nënshkruan marrëveshje apo protokolle bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit.
- e. Nënshkruan diplomat, dëshmitë dhe çerifikatat, për kursantë, studentë, punonjës të policisë së shtetit dhe të adheve të tjera ligjzbatuese.

VI. MBIKËQYRJA

Mbikqyret drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithëm i Policisë së Shtetit dhe për anën arsimore nga Ministri i Arsimit dhe Sporteve.

VII. KUSHTET E PUNËS

Sipas kushteve të përcaktuara në kreun IV “Kushtet e Punës, të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750 datë 16.09.2015. Trajtimi financiar bëhet sipas VKM përkatëse “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, si dhe Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015.

VIII. KËRKESAT E POSAÇME

- a. Kandidati për Rektor vetëkandidohen dhe konkurojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 39, të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
- b. Kandidati vjen nga radhët e personelit akademik të institucionit të AS-së dhe mban titullin “Profesor”, dhe në mungesë të kandidaturave nga AS-ja, pranohen kandidatura nga jashtë këtij institucioni, të cilat mbajnë titullin “Profesor”;
- c. Kandidati të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vite përvojë akademike në mësimdhënie ose në kërkim shkencor;
- d. Kandidati të ketë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, të ketë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të ketë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të ketë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 vitesh;
- e. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- f. Të mos ketë papajtueshmëri, në kuptim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- g. Zgjedhja e Rektorit realizohet në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me Rregulloren e zgjedhjeve të Akademisë së Sigurisë.
- h. Rektori dekretohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe të ministrit përgjegjës për Arsimin e Lartë, pas votimit që është bërë në AS, në zbatim të rregullave të përcaktuara nga ligji për arsimin e lartë.
- i. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

IX. DETYRA TË TJERA

- a. Angazhohet në procesin e mësimdhënies në Fakultetin e Sigurisë dhe hetimit, Kolegjit Profesional të Formimit Policor, apo trajnime apo specializime të ndryshme.
- b. Merr pjesë në konferenca apo simpoziume të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, universitetet të ndryshme, apo policia e shtetit.

- c. Merr pjesë në grupe pune të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, DPPSH, në lidhje me arsimimin dhe trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit